



Përshkrimi i Programit

Master Shkencor në Planifikim dhe Arkitekturë Peizazhi

Pse një Master në “Planifikim dhe Arkitekturë Peizazhi”

- Thellon, specializon dhe integron kompetencat e fituara në ciklin Bachelor në analizën, planifikimin, projektimin dhe menaxhimin e peizazhit.
- I përgjigjet nevojës për profesionistë të nivelit të avancuar për shkak të urbanizimit të shpejtë, transformimeve territoriale, presionit mbi burimet natyrore dhe rreziqeve klimatike.
- Ofron dy profile të qarta specializimi: Arkitekturë Peizazhi dhe Planifikim Peizazhi.
- Përgatit studentët për role drejtuese në projekte komplekse urbane e territoriale, për kërkim të aplikuar dhe për vazhdimin e studimeve doktorale.
- Është i harmonizuar me orientimin e reformës UBT–BOKU 2030 dhe me standarde europiane të formimit në peizazh dhe planifikim.

Kompetencat e të diplomuarve

- Kryejnë analiza të integruara territoriale dhe interpretojnë të dhëna hapësinore, statistikore dhe mjedisore.
- Hartojnë vizione, skenarë zhvillimi dhe dokumente strategjike për planifikimin e peizazhit dhe territorit.
- Zhvillojnë projekte komplekse urbane dhe territoriale në fushën e arkitekturës së peizazhit.
- Integrojnë infrastrukturën e gjelbër/blu, zgjidhjet e bazuara në natyrë dhe objektivat e adaptimit klimatik në plane dhe projekte.
- Përdorin në mënyrë të avancuar GIS, CAD, modelim hapësinor dhe mjete të tjera digjitale.
- Drejtojnë ekipe ndërdisiplinore, procese konsultimi publik dhe bashkëpunime ndërinstitucionale.
- Projektojnë dhe realizojnë kërkime të aplikuara dhe përgatisin tezë Master me metodologji të qartë kërkimore.
- Veprojnë me integritet profesional, etikë publike dhe përgjegjësi ndaj qëndrueshmërisë mjedisore.

Punëdhënësit e mundshëm dhe/ose rruga e karrierës

- Bashkitë dhe strukturat e planifikimit vendor, gjelbërimit urban dhe menaxhimit të territorit.
- Institucionet dhe agjencitë e planifikimit territorial, mjedisit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura.
- Studio projektimi, kompani ndërtimi dhe kompani të projektimit/realizimit të hapësirave të gjelbra, parqeve dhe kopshteve.
- Kompani dhe zyra konsulence në planifikim territorial, mjedis, GIS, VNM/VSM dhe menaxhim peizazhi.

- Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillim rural, turizëm natyror, biodiversitet, restaurim ekologjik dhe adaptim klimatik.
- Organizata joqeveritare dhe programe zhvillimi që punojnë me territorin, mjedisin dhe komunitetet.
- Vazhdim i karrierës akademike dhe kërkimore në studime doktorale.

Si zbatohet ndërdisiplinariteti i programit?

- 5% e krediteve janë lëndë bazë dhe metodologjike.
- 45% e krediteve janë lëndë karakterizuese të disiplinës.
- 15% e krediteve janë lëndë ndërdisiplinore/integruese.
- 10% e krediteve janë lëndë plotësuese.
- 25% e krediteve janë detyrime përmbyllëse (tezë diplome).
- Programi ndërthur planifikimin territorial, arkitekturën e peizazhit, zhvillimin rural, aspektet socio-ekonomike, ekologjinë, teknologjitë digjitale dhe analizën gjeohapësinore.
- Në vitin e parë ofrohet një bërthamë e përbashkët metodologjike, ndërsa në vitin e dytë programi profilizohet në dy drejtime: Arkitekturë Peizazhi dhe Planifikim Peizazhi.
- Programi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe angleze.

Cilat programe Bachelor sugjerohen për këtë Master

- Bachelor në Planifikim dhe Arkitekturë Peizazhi
- Bachelor në Arkitekturë
- Bachelor në Planifikim Urban/Rajonal
- Bachelor në Inxhinieri Mjedis
- Bachelor në Shkenca Pyjore
- Bachelor në Hortikulturë / Agronomi
- Bachelor në Gjeografi / GIS

Lista zyrtare e lëndëve për çdo semestër

Semestri 1

- Planifikim Peizazhi dhe Hapësinor i Avancuar
- Arkitekturë Peizazhi e Avancuar
- Metodatat Digjitale dhe Gjeohapësinore në Projektimin e Peizazhit
- Planifikim Territori dhe Zhvillim Rural
- Lëndë me zgjedhje (sipas profilit)

Semestri 2

- Projekt i Planifikimit Hapësinor
- Studio e Avancuar – Projektimi i Sistemeve të Peizazhit
- Planifikim dhe Projektim Urban me Bazë Natyrën
- Metodatat Kërkimore në Planifikim Peizazhi dhe Arkitekturë Peizazhi
- Lëndë me zgjedhje (sipas profilit)

Semestri 3

- 5 lëndë me zgjedhje (sipas profilit)

Semestri 4

- Seminar për Temën e Masterit
- Mbrojtje e Temës së Masterit

Lëndët me zgjedhje – Profili “Planifikim Peizazhi”

- Planifikim për Turizmin Natyror
- Qeverisje Urbane dhe Rajonale
- Projekt Specializimi në Planifikim Peizazhi
- Planifikimi dhe Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura të Mëdha
- Planifikimi Hapësinor dhe Peizazhi i Orientuar nga Risku
- Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
- Ekologji e Peizazhit, Rehabilitim i Habitave dhe Natyrës
- Menaxhimi i Peizazheve Bregdetare
- Teledeteksion dhe GIS i Avancuar
- Ekologjia e Sistemeve Akutike
- Ekologjia e Tokës
- Ekologjia Urbane
- Menaxhimi i Zbatuar i Peizazhit
- Menaxhimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Zgjidhjet me Bazë Natyrën
- Menaxhimi i Burimeve Ujore
- Drejtësia Mjedisore dhe Konfliktet dhe Konkurrenca për Burime
- Qeverisja, Fatkeqësitë Natyrore dhe Drejtësia
- Sistemet e Energjisë së Qëndrueshme

Lëndët me zgjedhje – Profili “Arkitekturë Peizazhi”

- Kërkim i aplikuar në arkitekturë peizazhi
- Metoda të Avancuara Digjitale: Elementë të BIM në Arkitekturë Peizazhi
- Projektim i Detajuar Teknik 1 – konstruksionet, themelet, piketimet dhe projektimi i kuotave në arkitekturë peizazhi
- Projektim i Detajuar Teknik 2 – sistemet e kullimit dhe ujitjes
- Menaxhim Kantieri dhe Zbatimi i Projektit të Peizazhit
- Menaxhimi i Peizazhit të Ndërtuar
- Gjelbërimi i Ndërtesave – Funkcionet dhe Teknologjitë Bazë
- Teknikat e ndriçimit
- Teknologjitë e Menaxhimit të Ujitjes
- Menaxhim Biznesi